



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

DREJTUESI I PROKURORISË SË LUSHNJËS, ÇLIRIM SHAHINI, NUK JUSTIFIKOI PASURINË, PROBLEME EDHE ME PASTËRTINË E FIGURËS

Kreu i Prokurorisë së Lushnjës, Z. Çlirim Shahini, është shkarkuar nga Komisioni i shkallës së parë të vettingut (KPK), për shkak të problemeve me pasurinë dhe figurën. Çlirim Shahini është përfshirë në sistemin e Prokurorisë fillimisht si oficer i Policisë Gjyqësore. Në vitin 2004 është emëruar prokuror në Sarandë, ku ka mbajtur këtë detyrë deri në vitin 2016. Nga ky viti është transferuar me rritje në detyrë, nga ish-kryeprokurori, Z. Adriatik Llalla, duke i dhënë drejtimin e Prokurorisë së Lushnjës.

Çlirim Shahini doli para Komisionit të Pavarur në seancën dëgjimore, një vit pas hedhjes së shortit, duke u vlerësuar vetëm në dy kritere, atë të pasurisë dhe figurës, ndërkohë që subjekti këmbënguli edhe për kryerjen e vlerësimit të aftësive profesionale.

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, në raportin e dorëzuar në KPK, vlerësonte se subjekti Shahini kishte kryer deklaram të saktë dhe nuk gjendej në situatën e konfliktit të interesit. Por nga hetimi i thelluar dhe analiza financiare e kryer nga KPK-ja, rezultuan pasaktësi në deklaramet e Shahinit. Subjekti kishte deklaruar si pronë, dy kate dhe papafingon, të ngritura mbi tre kate të një ndërtese të mikut të tij, në bregdetin e Sarandës, me vlerën e 10.5 milionë lekëve. Për ndërtimin e objektit (pjesa takuese e subjektit), ishin përdorur veç të ardhurave të subjektit nga paga e tij, e bashkëshortes dhe pensioni i nënës, edhe 35 mijë euro hua, për të cilat trupi gjykues ngriti dyshime mbi burimet e të ardhurave të huadhënësit, duke u shprehur se ka konstatuar pamjaftueshmëri financiare. KPK ka nxjerrë në pah edhe mos deklarimin periodik për një hua prej 2.7 milionë lekësh marrë nga subjekti, ndërtuesit të godinës.

Lidhur me kriterin e figurës, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar konstatoi papërshtatshmërinë e kryeprokurorit të Lushnjës për të vazhduar detyrën.

Sipas DSIK, subjekti ka përdorur mjetin e shtetasit A.D, i dënuar për “trafik lëndësh narkotike” në Greqi, por edhe i akuzuar në Shqipëri, për veprën penale “Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit”. Ndaj subjektit ishin depozituar edhe tre denoncime për shtyrje të afateve të hetimit dhe shkelje procedurash. Subjekti kërkoi nga trupi gjykues gjatë seancës dëgjimore hetim të thelluar për pastërtinë e figurës, madje ngriti dyshime për dëmtim të qëllimshëm të figurës së tij, duke akuzuar për keqdashje edhe Shërbimin Informativ Shtetëror.

Subjekti mund ta ankimojë vendimin pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, brenda 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.